**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

Data: 14.09.2023 | Nr: 000-025 | Ora: 11:04

# VENDIM

## PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË ORA NEWS / MEDIA, PËR AKREDITIMIN E VËZHGUESVE PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS TË DATËS 24 SHTATOR 2023

Sot në datën 14.09.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën e:

KËRKUES: ORA NEWS / MEDIA, me adresë në Rr."Aleksander Moisiu" Nr 76, Ish-Kinostudio "Shqiperia e Re", Tirana – Albania, Web Site: www.oranews.tv

OBJEKTI: Kërkohet akreditimi si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve te pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 shtator 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë". Vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave".

## V Ë R E J:

ORA NEWS / MEDIA i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 7 vëzhguesve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre.

Kërkesa është paraqitur në datën 14.09.2023.

ORA NEWS / MEDIA, në respektim të nenit 6, pika 2 të Kodit Zgjedhor është një organizatë që gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje.

Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor.

Dokumentacioni shoqërues i kërkesës është në përputhje me përcaktimet e nenit 6, pika 4 e vijues të Kodit Zgjedhor

## PËR KËTO ARSYE:

Si dhe në mbështetje të neneve 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave",

## V E N D O S:

1. Akreditimin e 7 vëzhguesve të ORA NEWS / MEDIA për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 shtator 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 1 (një) dite nga shpallja e tij në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Aneksi 1: Lista e Vëzhguesve te Miratuar te ORA NEWS / MEDIA

| | Emri | Mbiemri | Mandati | Seriali | Zona e vezhgimit |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Mola | Luku | Media | 000025 | Kukës |
| 2. | Isa | Myzyraj | Media | 000026 | Kukës |
| 3. | Atilio | Bleta | Media | 000027 | Kukës |
| 4. | Alfred | Shkoza | Media | 000028 | Kukës |
| 5. | Denis | Sejdini | Media | 000029 | Kukës |
| 6. | Emiljan | Hysa | Media | 000030 | Kukës |
| 7. | Erton | Çeço | Media | 000031 | Kukës |